

THIRRJE PËR OFERTË

Fotografimi i monumeteve për librin/katalogun”trashëgimia siç shihet dhe interpretohet nga nxënësit’ në kuadër të projektit “Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut”

Projekti “Treguesit e rinjë të trashëgimisë së Istogut” synon të kontribuojë në përmirësimin e njohurive të të rinjve dhe pjesëmarrjen e tyre në mbrojtjen dhe promovimin e kulturës dhe trashëgimisë së Istogut. Grupi kryesor i synuar i projektit janë fëmijët e shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Istogut. Ky projekt mundësohet nga Programi Rajonal mbi Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD dhe financohet nga Bashkimi Evropian, me bashkë-financim nga Komuna e Istogut, dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

EC Ma Ndryshe fton kompanitë dhe personat individual/fotografët e pamvarur të interesuar të dorëzojnë ofertat e tyre për angazhimin e mëposhtem:

Fotografimi i monumeteve për librin/katalogun”trashëgimia siç shihet dhe interpretohet nga nxënësit’

Libri i trashëgimisë i përmbanë 40 tregime të nxënësve (1 faqe A4 për tregim) për monumente të trashëgimisë kulturore, fetare, natyrore, zeje të vjetër, festival, traditë apo karakteristike tjetër të komunës së Istogut. Libri do të shërbejë si material informues mbi trashëgiminë kulturore dhe historike të Istogut sipas vështrimit dhe interpretimit nga nxënësit dhe si i tillë do të shpërndahet në shkollat e Istogut dhe promovohet si material për promovimin e turizmit të Istogut.

Kompanitë dhe personat individual/fotografët e pamvarur do të bëjnë fotografi për të gjitha tregimet që i përmban libri/katalogu. Për secilin tregim kërkohet të bëhet fotografia të paktën nga 3 pozicione përfshirë edhe detaje me rëndësi që përfaqësojnë objektin. Fotografitë duhet të kenë karakter promovues. Fotografitë duhet të dorëzohen si Jpg të formatit RGB. Rezolucioni i punimeve nuk duhet të jetë më i vogël se 6000x4000 px. Fotografitë do të realizohen në komunën e Istogut. Të drejtat për shfrytëzimin e fotografive i takojnë vetëm EC Ma Ndryshe.

Afati për përfundim

Fotografitë në verzionin final në mënyrë elektronike/email dhe me USB/CD duhet të dorëzohen deri më 29 Maj 2020.

Kriteret për ofertim:

- Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim: Çertifikata e regjistrimit të biznesit, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSh-së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së),
- Personat individual/fotografët e pamvarur duhet të dërgojnë vetëm CV-në dhe ofertën,
- Çmimi duhet të përfshijë koston profesionale dhe atë të transportit.
- Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt për komunikim me EC Ma Ndryshe;
- Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyrat e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ose në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org deri më datë 22.05.2020, ora 15:00 me shënim: *Ofertë për "Fotografimi i monumeteve për librin/katalogun" trashëgimia siç shihet dhe interpretohet nga nxënësit.*
- Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: info@ecmandryshe.org deri më datë 21.05.2020.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë apo personat individual/fotografët e pamvarur nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm kompanitë apo personat individual/fotografët e pamvarur fitues do të informohen/kontaktohen. Për më shumë informacione rreth kësaj thirrjeje për aplikim, ju lutemi vizitoni www.ecmandryshe.org/konkurse.